



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 68, datë 10.06.2021

PËR

**MIRATIMIN E SKENARIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE, BAZUAR NË  
VENDIMIN NR. 6, DATË 20.05.2021 TË KOMITETIT PËR MENAXHIMIN E  
INTEGRUAR TË MBETJEVE DHE VENDIMIN NR. 3, DATË 02.06.2021 TË  
KËSHILLIT TË QARKUT DURRËS**


Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjit nr.10431, datë 09.07.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, VKM-së nr. 967, datë 25.10.2013, pika 4/c “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, VKM-së nr.418, datë 27.05.2020 “ Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, VKM-së nr. 389, datë 27.06.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr.452, datë 11.07.2012 "Për Lendfillet e mbetjeve", Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.06, datë 13.01.2020 “Për miratimin e lejes së infrastrukturës: “Mbyllja e vendepozitimit të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i ECO-PARK me vendndodhje në Bashkinë Durrës”, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Vendimit nr. 6, datë 20.05.2021 i Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Vendimit nr. 3, datë 02.06.2021 i Këshillit të Qarkut Durrës, VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afat mesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si dhe sipas relacionit bashkëlidhur këtij vendimi, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në Vendimit nr. 6, datë 20.05.2021 të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimit nr. 3, datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës, sipas relacionit bashkëngjitur.
2. Të kërkohet nga Qeveria Shqiptare ose organe përfaqësuese të saj për të marrë përsipër realizimin e investimeve të nevojshme lidhur me stacionin e transferimit ku do të depozitohet Bashkia Durrës duke marrë parasysh kufjtë administrative të Bashkive të Qarkut Durrës në pika të arritshme edhe nga bashkitë e tjera.
3. Të kërkohet nga Qeveria Shqiptare miratimin e subvencionimit të plotë të tarifës hyrëse për një afat 10 vjeçar sipas planit afatgjatë të buxhetit, duke qenë se Bashkia Durrës ka kaluar pasoja qoftë prej pandemisë globale ashtu dhe prej gjendjes së jashtëzakonshme shpallur si rrjedhim të goditjes nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 me VKM-në nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”.
4. Të kërkohet që Bashkia Durrës të bashkëpunojë me Bashkinë e Tiranës për të vijuar më tej procedurat në zbatim të dispozitave ligjore administrative në fuqi, kjo në bazë të pikës 9.2.2 Zona e Menaxhimit të Mbetjeve në Vendimin Nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Strategjinë Sektoriale, Planin e Zhvillimit të Sektorit dhe Hartat Bazë” nga ku nevojitet që çdo bashki të jetë pjesë e një ZMM-je, në rastin tonë ZMM Tiranë - Durrës përfshin Qarkun Tiranës dhe Qarkun e Durrësit duke qenë se landfilli i Sharrës dhe impianti i trajtimit të mbetjeve, që do të ndërtohet ndodhet nën territorin e administrimit të Bashkisë së Tiranës
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoritë e Bashkisë Durrës .
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar)

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 10.06.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

RELACION

PËR MIRATIMIN E ANALIZËS SË OPSIONEVE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË QARKUN DURRËS SIPAS SKENAREVE NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE URBANE NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 dt.17/12/2015 "Për vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, Ligjit Nr.10431, datë 09. 07. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, VKM-së nr. 967, datë 25.10.2013, pika 4/c "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve", VKM-së nr.418, datë 27.05.2020 " Për miratimin e Dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035", VKM-së Nr. 389, datë 27.06.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në Nr.452, datë 11.07.2012 "Për Lendfilllet e mbetjeve", Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 06, datë 13.01.2020 "Për miratimin e lejes së infrastrukturës: "Mbyllja e venddepozitimit të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i ECO-PARK me vendndodhje në Bashkinë Durrës", Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 13.01.2020 "Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta", ju paraqesim relacionin si më poshtë;

Të nderuar këshilltarë,

Referuar situatës kritike në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, të cilat janë mesatarisht 75 500 ton mbetje në vit, bazuar dhe në Vkm-në nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020-2035". Pika 7, menaxhimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake, procedurat ligjore ngarkojnë bashkitë me përgjegjësi për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe për menaxhimin e impianteve të trajtimit të tyre.

Gjatë vitit 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me programin zviceran për zhvillim lokal dhe decentralizim (DLDP), kanë identifikuar në të gjithë vendin 199 venddepozitime ilegale dhe legale. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka menduar për ato bashki, të cilat ende nuk kanë një lendfill sanitar apo incinerator brenda qarkut të tyre, të kryejnë rehabilitimin e një venddepozitimi për çdo bashki për një periudhë tranzitore deri në ndërtim e pikës fundore, në përputhje me standardet mjedisore, ndërsa të gjitha venddepozitimet e tjera duhen mbyllur menjëherë. Në territorin tonë përveç VGM-së së Porto Romanos (e cila u mbyll), ndodhen dhe 3 VGM të tjera (përkatësisht Vadardh Sukth, Fush Biz Ishëm dhe Gryk Minier Manëz) të cilat sipas VKM-së Nr. 389, datë 27.06.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në Nr.452,

datë 11.07.2012 "Për Lendfilllet e mbetjeve", sipas hartëzimit negativ kanë dalë për mbyllje, pasi nuk kanë kapacitete dhe kushte teknike për të vazhduar të qëndrojnë venddepozitime sipas kriterëve ligjorë e teknike, pra Bashkisë Durrës nuk jua akordua fond për rehabilitim të një venddepozitimi ekzistues, duke e përdorur atë për një periudhë tranzitore po ju mbyll një nga venddepozitimet ekzistuese duke e futur në një situatë kritike.

Sqarojmë se Bashkia e Durrësit është një nga bashkitë me taksa – tarifa me të ulëta në Republikën e Shqipërisë, kjo është e evidentueshme edhe nga paketa fiskale e vitit 2021. Pra në kuadër të kësaj problematike ne jemi të detyruar aktualisht të kërkojmë financim nga qeveria shqiptare, deri në momentin e masës së përballeshme nga vetë Institucioni.

Bazuar në Vendimin Nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Strategjinë Sektoriale, Planin e Zhvillimit të Sektorit dhe Hartat Bazë”, na behet me dije se territori i Shqipërisë do të demarkohet në 10 zona mbetjesh, ku Zona Tiranë-Durrës përfshin qarkun e Tiranës dhe qarkun e Durrësit, zonë e cila sipas VKM 418 datë 25.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020-2035”, për çdo zonë do të përgatiten studime fizibiliteti rajonale, të cilat hartohen nga ministria përgjegjëse, dhe do të shërbejnë si bazë për vendimarrjen. Asokohe në mungesë të një studimi fizibiliteti në nivel rajonal, Bashkia Durrës ju drejtua Kryeministrit me shkresën me Nr. 10946 prot. Datë 01.09.2020 duke i propozuar 3 alternativa për ti dhënë një zgjidhje situatës ku ndodhej. Alternativat e propozuara nga ana jonë tregohen më poshtë bazuar në 3 dokumente orientuese, përkatësisht:

1. Vendi Sukth-Rada i propozuar nga “Studim për përcaktimin e territorit për asgjësimin e mbetjeve të ngurta (landfillit sanitar) në Durrës, Shqipëri” hartuar nga A.S.A International Environmental Services GmbH Austri dhe GEOTest , a.s. Republika Çeke më datë 18.05.2011 ku do të përdorej vetëm nga Bashkia Durrës,
2. Vendi në Gjepalaj, Shijak, i propozuar nga studimi “Studim për asgjësimin e mbetjeve të ngurta (landfilli sanitar) në Gjepalaj” i hartuar nga Taulant shpk i interesuar për të kryer këte lloj aktiviteti, territor nën administrimin e njësisë vendore Shijak,
3. Vendi i 3 bazuar në planin kombëtar sektorial të menaxhimit të mbetjeve i miratuar Vendimin Nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Strategjinë Sektoriale, Planin e Zhvillimit të Sektorit dhe Hartat Bazë, duke përfshirë dhe koston për transportin 4 euro.

|           | <b>Vendi i propozuar “Sukthi-Rada”.</b><br>Ndërtimi i një landfilli të ri nga Studimi A.S.A Republika Çeke 2011 ku do të përdoret vetëm nga Bashkia Durrës jo në nivel qarku Afati kohor 20 vjet | <b>Vendi i propozuar në Gjepalaj Shijak</b><br>Afati kohor 20 vjet  | <b>Dërgimi i mbetjeve në Tiranë duke qënë pjesë e zonës së mbetjeve Tiranë – Durrës (referuar Planit kombëtar sektorial )</b><br>Afati kohor 20 vjet |
|-----------|--|---|--|
| Investimi | 11,025 Mil € pa TVSH vlerë e cila përfshin Faza I- Faza V  | 5,2 Mil € pa TVSH, sipas studimit të fizibilitetit përfshin koston e investimit së bashku me vlerësimin e pronës sipas tregut | 51,1 mln € pa TVSH duke përfshirë dhe koston e transportit 4 euro  |

Këto alternativa nuk u aplikuan për arsye të:

1. Mungesës në vendimarrjen përkatëse nga autoritetet përgjegjëse.
2. Mungesës së fondeve.

Buxheti i bashkisë e ka të pamundur përballimin e një kosto investimi fillestare. Një pasqyrë financiare e buxhetit e ndarë në zëra, përkatësisht:

| Viti | Fondi për menaxhimin e mbetjeve ne leke | Buxheti total ne lek | Volumi kundrejt buxhetit ne % | Të ardhurat nga tarifat e pastrimit ne leke | % e mbuli mit te sherbi mit nga tarifa | Investimet ne leke | Investimet ne euro | Kursi i kembimit lek/euro |
|------|---|----------------------|-------------------------------|---|--|--------------------|--------------------|---------------------------|
| 2017 | 371,381,000                             | 2,159,333,000        | 17%                           | 155,573,000                                 | 42%                                    | 599,095,000        | <b>4,819,750</b>   | 134.2                     |
| 2018 | 363,021,000                             | 2,273,019,000        | 16%                           | 165,847,000                                 | 46%                                    | 646,706,000        | <b>5,202,783</b>   | 127.6                     |
| 2019 | 367,855,000                             | 2,877,264,000        | 13%                           | 170,003,000                                 | 46%                                    | 1,053,286,000      | <b>8,473,740</b>   | 123.0                     |
| 2020 | 383,294,000                             | 2,432,953,000        | 16%                           | 112,713,000                                 | 29%                                    | 659,448,000        | <b>5,326,721</b>   | 123.8                     |
| 2021 | 417,847,000                             | 3,068,972,000        | 14%                           | 256,334,000                                 | 61%                                    | 876,353,000        | <b>7,078,780</b>   | 123.8                     |
| 2022 | 414,847,000                             | 3,129,214,000        | 13%                           | 258,801,000                                 | 62%                                    | 936,719,000        | <b>7,566,389</b>   | 123.8                     |
| 2023 | 414,847,000                             | 3,232,402,000        | 13%                           | 261,475,000                                 | 63%                                    | 1,034,907,000      | <b>8,359,507</b>   | 123.8                     |

Bashkia Durrës në bazë të kërkesave të vazhdueshme ka kërkuar mbështetje nëpërmjet komunikimeve të mëparshme me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, për zgjidhjen e situatës emergjente në lidhje me menaxhimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Durrës. Deri më tani për shkak të pamundësive financiare dhe duke qenë se impiantet në shkallë të gjerë zakonisht kërkojnë kosto të lartë investimi vështirësia në menaxhimin e situatës së mbetjeve është thelluar.

Ju bëjmë me dije se me anë të shkresës me Nr. 233/1 prot. datë 14.05.2021 protokolluar pranë nesh me Nr. 5957 prot. datë 17.05.2021 Këshilli i qarkut Durrës na përcjell studimin “Analizimi i opsioneve për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Durrës” me alternativat për zgjidhje të problematikës së mbetjeve, i dërguar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) në kuadër të programit “Menaxhim i qëndrueshëm dhe miqësor në sektorin e mbetjeve” financiar nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW dhe Konsulenti “p2mberlin & Enviroplan”.

Ky studim i është paraqitur Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUMI) me anë të shkresës me Nr. 995 prot. datë 12.05.2021 ku i kërkohet miratimi i alternativës së propozuar nga to, për zgjidhjen e problematikës për Qarkun Durrës. Në këtë dokument janë paraqitur 3 alternativa, përkatësisht:

**Skenari 1** Sistemi i operimit me 3 kosha ku Qarku Durrës do të qëndroj si zonë më vete operimi në menaxhimin e integruar të mbetjeve.

**Skenari 2** është Sistemi i 2 koshave ku qarku Durrës i bashkohet Zonës së menaxhimit të mbetjeve ZMM Tiranë – Durrës të përcaktuar në Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”.

**Skenari 3** Sistemi i dy koshave ku konfirmohet ZMM Tiranë–Durrës sipas Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, por me një shtesë që mbetjet e riciklueshme do të trajtohen në territorin e Bashkisë Durrës dhe lënda e parë e tyre do të ripërdoret ndërsa mbetjet që gjenerohen nga trajtimi i mbetjeve të riciklueshme dhe mbetjet e tjera bashkiake do të dërgohen në Tiranë.

Më poshtë jepet një tabelë, e cila ilustron të 3 Skenarët e sipërcituar me koston përkatëse të investimit dhe Tarifën hyrëse/të portës sipas pasqyrës financiare të arrirë nga analiza financiare e kryer nga dy studimet e fizibilitetit të përmendur më lart.

|                          | <b>Skenari 1</b><br>Qendrimi në Durrës si zonë më vete ZMM sistemi 3 kosha | <b>Skenari 2</b><br>Dërgimi i plotë në Tiranë, sistemi 2 kosha ZMM Tiranë-Durrës | <b>Skenari 3</b> Dërgim në Tiranë por duke trajtuar më parë mbetjet e riciklueshme, sistemi 2 kosha |
|--------------------------|--|--|---|
| Investimi total          | 50,711,166 €   | 5,500,000 €  | 7,493,540 €   |
| Tarifa portes            | 52.64 €/t  | 40.57 €/t  | 57.1 €/t  |
| Afati kohor i investimit | 2021 – 2035  | 2021 – 2035  | 2021 – 2035   |

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUMI) në bazë të Pjesës e 2, Pika 11. Masat e zbatimit në Vkm-në nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020-2035" citohet:..

“...M17. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Mbetjeve lehtëson marrëveshjet financiare në nivelin e zonave të mbetjeve për bashkitë dhe autoritetet menaxhuese të njësive për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve. Në zonat ku janë ndërtuar impiante trajtimi, tarifat janë përcaktuar në bashkëpunim me AKUM-në, duke marrë në konsideratë kapacitetin e bashkive për të përballuar tarifën dhe shkallën e mbulimit. Pushteti qendror përcakton në marrëveshje me bashkitë, përqindjen e financimit, në përputhje me plotësimin e nevojave kryesore për Rrjetin e Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve, duke reflektuar në të njëjtën kohë nivelin e përballueshmërinë prej bashkive dhe prej qytetarëve....” . Gjithashtu ju bëjmë me dije se AKUMI me anë të shkresës Nr. 493, Prot., datë. 12.05.2021, pasi shqyrtojë alternativat e marra nga studimi “Analizimi i opsioneve për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Durrës” propozon si zgjidhje të problemit mbi menaxhimin e mbetjeve për Qarkun Durrës, zbatimin e Skenarit 2 si alternativa më e preferuar në kuadër të analizës së detajuar të kostove për secilin Skenar të propozuar nga Studimi i sipërcituar.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUMI) me anë të shkresës me Nr. 493, Prot., datë. 12.05.2021 i vë Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në dispozicion studimin “Analizimi i opsioneve për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Durrës”, i cili doli në një vendim për zgjidhjen e problematikës së mbetjeve në Qarkun Durrës. Vendimi në fjalë, me Nr. 6, datë 20.05.2021 përcakton:

1. Miratimin e analizës së opsioneve të menaxhimit të mbetjeve në qarkun Durrës sipas Skenarit 2 të dërguar nga AKUMI.
2. Zbatimi i skenarit nr. 2 të planifikuar në analizën e opsioneve të menaxhimit të mbetjeve në qarkun Durrës, të kryhet nga AKUMI.
3. Komiteti ka në fokus gjithë procesin e politikave mjedisore në vend dhe nuk përcakton, ndjek apo zhvillon procedura tenderimi duke përfshirë kostot financiare dhe procedurat e tjera të kësaj natyre.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas marrjes së mendimit të Këshillit të Qarkut Durrës.

Paralelisht Këshilli i Qarkut Durrës në zbatim të VKM nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e Dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, pika 9.2.2 ku përcaktohet se: Zona e Menaxhimit të Mbetjeve karakterizohet nga: Kufijtë e zonës janë bazuar mbi një marrëveshje ndërbashkiake bashkëpunimi dhe / ose nga miratimi i Këshillit të Qarkut (kur kufijtë e zonës përputhen me kufijtë administrativë të qarkut), mori në mbledhjen e datës 02.06.2021 Vendimin nr. 3, nr. 270/1 Prot në bazë të të cilit është vendosur:

Miratimi i analizës së opsioneve të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun e Durrësit sipas skenarit nr. 2. Vendim i cili ju përcoll institucionit të Bashkisë Durrës me anë të shkresës Nr. 239/6 datë 07.06.2021.

Praktika e zbatimit të Skenarit nr 2:

Zbatohet sistemi i mbledhjes së dy (2) koshave (1 kosh për mbledhjen e materialeve të riciklueshme, 1 kosh për grumbullimin e mbetjeve të mbetura bashkiake). Ricikluesit dhe mbetjet e mbetura do të transferohen përmes Stacionit të Transferimit në Qendrën e Menaxhimit të Mbetjeve në Tiranë për trajtim të mëtejshëm. Stacioni Transferimit do të ngrihet brënda territorit të Qarkut Durrës i cili do të mbulojë të 3 Bashkitë pjesmarrëse. Kosto e investimit e cila pasqyrohet e detajuar me poshtë mbulon dhe kostot e ndërtimit të Stacionit të Transferimit.

Kostot e investimit të skenarit 2 të propozuar nga Studimi “Analizimi i opsioneve për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Durrës” i miratuar nga Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Këshilli i Qarkut Durrës janë të spjeguar në dokumentin bashkëngjitur, ku shkurtimisht:

1. Sistemi i mbledhjes së dy koshave (koshi i mbeturinave të riciklueshme dhe koshi i mbeturinave) Transportimi i të gjitha mbetjeve në Qendrën e Trajtimit të Mbetjeve në Tiranë përmes Stacionit të transferimit që do të ndërtohet në Durrës.
2. Kosto e investimit parashikohet në ndërtimin e stacionit të transferimit me një vlerë 5,000,000 euro
3. Sipas studimit “Analizimi i opsioneve për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Durrës” kosto dinamike e cmimit DPC është ekuivalent deri në tarifën e portës, €/t e mbeturinave rezultojnë 40.5 €/t

Vlen të theksohet se në Vendimin Nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Strategjinë Sektoriale, Planin e Zhvillimit të Sektorit dhe Hartat Bazë”, pika 8.8.4 Përllogaritja e kostos për Zona e Mbetjeve Tiranë –Durrës fq. 124-125 citohet:

“... Sipas informacioneve MIE, bashkitë që përdorin impiantin e incinerimit të mbetjeve që kanë lidhje me të do të paguajnë një tarifë hyrëse prej **29 euro** për ton mbetje dhe si rrjedhim kostot vjetore të impianteve rajonale janë llogaritur në këtë bazë....”

Për sa më lart në zbatim të legjisllacionit në fuqi kërkojmë:

1. Miratimin e skenarit bazuar në Vendimit nr. 6 datë 20.05.2021 të Komitetit Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimit nr. 3 datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës.
2. Në bazë të pikës 9.2.2 Zona e Menaxhimit të Mbetjeve në Vendimin Nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Strategjinë Sektoriale, Planin e Zhvillimit të Sektorit dhe Hartat Bazë” ku kërkohet që çdo bashki të jetë pjesë e një ZMM-je, në rastin tonë ZMM Tiranë- Durrës përfshin Qarkun Tiranës dhe Qarkun e Durrësit dhe landfilli i Sharrës dhe impianti i trajtimit të mbetjeve që do të ndërtohet, ndodhet nën territorin e administrimit të Bashkisë së Tiranës, Bashkia Durrës të bashkëpunojë me Bashkinë e Tiranës për të vijuar më tej procedurat në zbatim të dispozitave ligjore administrative në fuqi.
3. Të kërkohej nga Qeveria Shqiptare ose organe përfaqësuese të saj për të marrë përsipër realizimin e investimeve të nevojshme lidhur me stacionin e transferimit ku do të depozitohet Bashkia Durrës duke marrë parasysh kufjtë administrativë të Bashkive të Qarkut Durrës në pika të arritshme edhe nga bashkitë e tjera.
4. Të kërkohej nga Qeveria Shqiptare miratimin e subvencionimit të plotë të tarifës hyrëse për një afat 10 vjeçar sipas planit afatgjatë të buxhetit, duke qenë se Bashkia Durrës ka kaluar pasoja qoftë prej pandemisë globale ashtu dhe prej gjendjes së jashtëzakonshme shpallur si rrjedhim të goditjes nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 me VKM-në nr. 750 datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

**PËR DREJTORINË E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT,**

Shpëtim Ciku

Rudina Trikshiçi

Edlira Kërtusha

Klara Agasi

Ermal Lama

**PËR NDËRMARRJEN E SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS,**

Krisel Koça

Shpetim Hidri

**PËR NDËRMARRJEN E SHËRBIMEVE KOMUNALE PLAZH,**

Blerina Kthupi

Alfred Dhuli





PËR DREJTORINË SHËRBIMEVE PUBLIKE,  
Ardjan Iljazaj

PËR DREJTORINË E BUXHETIT,  
Valbona Qirjako

PËR DREJTORINË EKONOMIKE,  
Ermal Lufo

PËR DREJTORINË LIGJORE,  
Arben Isaku



*[Handwritten signatures]*




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 414 / prot.  
2



Durrës, më 11 06 .2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK** ✓  
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.68 datë 10.06.2021 “Për miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në Vendimin Nr 6 datë 20.05.2021 të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimin Nr. 3 datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**  
**ROLAND NASTO**

